

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0485-A0001*****Në ankesën e******Paditësi*****Z S** fshati S, Istog.**kundër****E paditura/Ankuesja**

**NSH. "Dubrava"**, (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. " Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2406 të datës 09 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 21 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS C-IV-14-2406 i datës 09 gusht 2022.**
- 3. Vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PEJ036-0283, i datës 20 mars 2014.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me 07 prill 2014, paditësi parashtroj në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ036-0283, të datës 20 mars 2014, me të cilën kërkesa e tij e datës 23 dhjetor 2013, për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 900,00 euro, refuzohet si e pa vlefshme, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë ai e kundërshton vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke pohuar se ishte punëtor i NSH."Dubrava", dhe se ka të drejtë në pagesën pagave të papaguara për periudhën kohore nga data 1 janar 2005 e gjer më 31 dhjetor 2006 në shumë totale prej 900.00 euro, ndaj NSH."Dubrava" (në likuidim). Bashkë me ankesë paditësi dërgon kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e Librit amëz të punëtorëve, nga e cila sipas numrit rendor 496 shihet emri i paditësit.

Me 31 janar 2022, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe në mënyrë të drejtë janë zbatuar dispozitat materiale. AKP-ja pohon se paditësi. AKP-ja pohon se paditësi nuk ka ofruar argumente ligjore, në favor të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore Shtojcës së Ligjit për AKP-në. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë e mbështet qëndrimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për kompensim e pagave të papaguara është e parashkruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar ( gazeta zyrtare nr. 53 të vitit 1976), pasi që paditësi nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi që pagat i ka kërkuar në afatin prej 3 vitesh. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Më 22 shkurt 2022, paditësi duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës parashtroi përgjigje me të cilën theksoi se mbetet në tersi pranë kërkesës për rishikim të ankesës.

Më 4 mars 2022, AKP-ja duke vepruar sipas urdhrit të gjykatës parashtroi kundërpërgjigjen e cila thekson se mbetet në tersi pranë përgjigjes si dhe ka theksuar se parashtruesi ka detyrim dhe barrën e provës konform nenit 7 të LPK-së dhe nenit 31 të Ligjit DHPGJS.

Me 09 gusht 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-2406, e aprovon pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PEJ036-0283, të datës 20 mars 2014, dhe e obligon të paditurën që paditësit në emër të kompensimit për paga të papaguara t'ia paguaj shumën prej 223.98 euro, ndërsa e refuzon pjesën tjetër të mbetur prej 676.02 euro, si të pa bazuar. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se paditësi ka ofruar prova të mjaftuara që dëshmojnë se ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit për likuidimit e NSH-së. Tutje Shkalla e I-rë ka arsyetuar se në bazë të Librit Amë si dhe kopjet e pasqyrës së të ardhurave të parashtruar nga AKP-ja, argumentojnë faktin se njëjti ka qenë punëtor aktiv i NSH-së. AKP nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga paditësi, respektivisht nuk e ka argumentuar të kundërtën me çka paditësit do të mohohej e drejta në kompensim dhe se AKP si arsye mbi refuzimin e kërkesës e potencon vetëm çështjen e parashkrimit. Në interpretim të nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, pagat e punonjësve janë të kufizuara në tre paga mujore bruto dhe se nga pasqyra e të ardhurave për vitin 2006 shihet se mesatarja e të ardhurave të paditësit 74,66 euro për muaj, andaj gjykata me rastin e vendosjes së shumës së kërkuar, morri mesataren e pagave për muajt shkurt-prill të vitit 2006, kjo shumë ishte shumëzuar për tre paga, e që përbën shumën e tërësishme prej 223.98 euro, kurse pjesa tjetër e kërkesës prej 676.02 euro, gjykata e refuzon për arsye sipas dispozitës si më lartë, paditësit i takon e drejta e kufizuar në tri paga mujore gjersa në interpretim të nenit 40 paragrafi 1.7 (kërkesat e pasiguruara përshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë) lidhur me nenin 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJD kërkesa e paditësit nuk është aprovuar. Lidhur me çështjen e parashkrimit, Shkalla e I-rë ka konstatuar se kërkesa nuk është përshkruar duke u nisur mbi parimet e përgjithshme mbi

parashkrimin të aplikuara sipas ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve gazeta zyrtare RSFJ nr.29/78 me plotësime dhe ndryshme 39/85, 45/89,31/93 duke konsideruar se kërkesa është e natyrës kreditore. Në neni 370 të po të njëjtit ligj thuhet :Rregullat per parashkrim nuk zbatohen në rastet kur me ligj janë caktuar aftët brenda të cilave duhet të paraqitet padia apo të kryhet një veprim në kërcënimin e humbjes së të drejtave. Tutje shkalla e I-rë ka konstatuar se rregullat per parashkrim nuk mund të zbatohen sepse veprimi i vetëm i paditësit në rastin konkret ishte drejtuar kërkesa e Autoritetit të Likuidimit dhe se afatet dhe procedurat e Likuidimit rregullohen me ligjin per AKP-në. Po ashtu Shkalla e I-rë ka arsyetuar se asnjë punëtor apo kreditor potencial nuk mund të realizojë të drejtat e tyre pa hapjen e procedurës së likuidimit nga AKP-ja

Me 19 gusht 2022, AKP-ja përmes postës e dërgon në DHPGJS një ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-2406, të datës 09 gusht 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka ngatërruar dy çështje që janë krejtësisht të ndryshme, afatin për dorëzimin e kërkesave në bazë të dëshmisë së interesit në procedurën e likuidimit që është afat për parashtrimin e kërkesave dhe afatin e dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë e që i referohet pagave të pa paguara (afati i parashkrimit) që është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara. Të dy afatet janë të ndara dhe të dallueshme dhe secili kreditor i NSH-së duhet të përmbush këto dy afate në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa. AKP-ja pretendon se kërkesa është parashkruar, andaj është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit.

Më 12 dhjetor 2023, Gjykata lëshoi urdhër për përgjigje në ankesë e cila i është dorëzuar paditësit në bazë të flet dorëzimit që ekziston në dosje, paditësi ankesën e AKP-së e ka pranuar me datë 18 dhjetor 2023, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në këtë ankesë.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën verbale të procedurës.

### **Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të ndryshohet dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 23 dhjetor 2013, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit ndaj NSH "Dubrava", (në likuidimi) dhe kërkon paga e pa paguara, në shumën prej 900.00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pa vlefshme nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është e parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit ka vërejtur që Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit si të bazuar, e ka shfuqizuar Aktgjykimin e ankimuar dhe e ka detyruar të paditurën që t'ia paguaj paditësit shumën prej 223.98 euro, në emër të kompensimit për paga të papaguara ndërsa pjesën tjetër prej 672.02 euro e ka refuzuar.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së I-rë, pajtohet me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa e paditësit për paga të papaguara për periudhën kohore nga data 1 janar 2005 e gjer më 31 dhjetor 2006 është parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ka sjellë kopjen e Librit amëz të punëtorëve si dhe kopjet e listës së të ardhurave personale. Këto prova mund të dëshmojnë se paditësi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj dhe se marrëdhënia e punës i ka pushuar si rrjedhojë e vendimit për likuidimit e NSH-së, por këto nuk janë prova të cilat e kanë ndërprerë parashkrimin e kërkesës.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me konstatimin e Shkalles së I-rë se kërkesa e paditësit nuk është parashkruar.

Kolegji i Apelit vlerëson se parashkrimi si institut i së drejtës civile në përgjithësi dhe në veçanti afati 3 vjeçar i parashkrimit për kërkesat monetare, është ruajtur në të gjitha ligjet, madje edhe te Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 690 i datës 30 mars 1978 (neni 372, paragrafi 1) dhe te Ligji i ri (neni 353, paragrafi 1, i LMD-së).

Kolegji i Apelit po ashtu vlerëson se e drejta për të kërkuar kompensimin e pretenduar për paga të pa paguara është ligjërisht e vjetërsuar pas 3 viteve, pasi që N.SH-ja nuk ka përmbushur detyrimin e saj ndaj parashtruesit të kërkesës brenda këtij afati dhe pasi që paditësi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka paraqitur kërkesë në ndonjë procedurë gjyqësore, apo para ndonjë autoriteti kompetent brenda afatit 3 vjeçar, për të kërkuar borxhin e pretenduar në lidhje me pagat e pa paguara dhe kështu për ta ndaluar rrjedhjen e afatit të parashkrimit. Paditësi ka pasur të drejtë të kërkoj përmbushjen e detyrimit të pretenduar pas çdo muaji të kaluar për të cilët nuk i është paguar paga, kështu që afati i parashkrimit ka rrjedhur për çdo muaj të pagave të pa paguara veç e veç. Kërkesa e paditësit për pagat e pa paguara për periudhën prej 01 janar 2005 deri me 31 dhjetor 2006, është parashkruar brenda afatit 3 vjeçar, që i bie se afati i parashkrimit për pagën e fundit ka arritur në dhjetor 2009, ndërsa paditësi kërkesën e ka parashtruar me 23 dhjetor 2013, që do të thotë jashtë çdo afati të paraparë ligjor.

Paditësi ka dështuar të sjellë në gjykatë, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, i cili dokument do ta ndërpriste rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës, pasi që në Njoftim AKM i ka udhëzuar palët që kërkesat kreditore ndaj NSH-së ti paraqesin në procedurën e likuidimit.

Andaj në mungesë të Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës e cila provë mungon në shkresat e lëndës, kërkesa për pagat e kërkuara është parashkruar.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

AKP-ja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 16 gusht 2022, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 21 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_